

EPPC Albania kërkon një **Business Relationship Manager** për qytetin e Tiranës, për klientin e saj.

Përgjegjësitë kryesore:

- Identifikon mundësi të reja biznesi dhe prezanton zhvillimin e modelit të biznesit të kompanisë tek partnerët potencial;
- Ndërton dhe mirëmban marrëdhënie me partnerët biznese;
- Përgjegjës për zhvillimin/rritjen e portofolit të klienteve, mbajtjen e sa më shumë pikave aktive si dhe kontraktimin e bizneseve të reja;
- Prezanton/sugjeron produktet dhe shërbimet e kompanisë tek çdo klient biznes, duke ofruar zgjidhje në përshtatje me kërkesat dhe nevojat e këtij të fundit;
- Trajton stafin e shitjes së klientit biznes me qëllim nxitjen e shitjeve të produkteve/shërbimeve të kompanisë, dhe sigurohet që ky proces bëhet konform prodeçurave në fuqi;
- Në bashkëpunim me departamentin e marketingut, ndihmon klientet me zgjidhje praktike për të nxitur me shume shitjet;
- Qëdron i përditësuar me trendet e industrisë, tregun dhe konkurrencën;
- Përgatit raporte në lidhje me shitjet sipas kërkesës

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- **Eksperiencë të mëparshme në shitjet në terren në B2B;**
- **Aftësi të mira të gjuhës Angleze;**
- Komunikim shumë i mirë dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie biznesi;
- Disiplinë dhe aftësi për të punuar i pavarur;
- Aftësi për të punuar nën presionin e arritjes së rezultateve;
- **Aftësi drejtuese të mjetit, patentë Klasi B.**

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.